



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



ZYRA E PROJEKTEVE
BIRO ZA PROJEKTE – PROJECT OFFICE



RAPORT

janar – 24 mars 2014

Raporti perfshinë bashkëpunimin në realizimin e projekteve me :

- Organizata Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera financiare
- Qeverinë e Republikës së Kosovës
- Drejtoritë Komunale
- Komunitetin Lokal – participimet në projekte
- Shoqerine Civile - organizatat dhe shoqatat e ndryshme
- Të tjera

Ju falemderojm për mirëkuptim,

Fadil OSMANI
Menaxher i zyrës së projekteve

24'mars 2014

Zyra e Projekteve është e fuqishme kur ajo ngritë nivelin e bashkëpunimit me Organizatat Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera financiare, dhe kjo është bërë me përkushtimin më të madh dhe të mundshëm edhe për keta tre (3) muaj të vitit 2014 ashtu siq ishte edhe viteve të mëparshëm .

Falë angazhimit të kësaj Zyre dhe punës që ka bërë për keta pak muaj me staf të përgjysmuar (ngase pjesa tjetër nuk ka qenë aktive për keto muaj) kemi arritur të përgatisim projekte dhe të aplikojmë në programe ku presim rezultate pozitive nga çdo thirrje që kemi aplikuar.

Në vazhdim ju ofrojmë projektet ku kemi aplikuar:

EU Programi – Kosova e Bukur - faza e II-të

NR.	EMRI I PROJEKTIT
01	Ndërtimi i parkut të qytetit në lagjen “Dardania I”
02	Ndërtimi i terreneve sportive dhe izolimi i objektit të shkollës fillore “Ibrahim Uruqi” në fshatin Bresalc

BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR KOSOVË – MAQEDONI

NR.	EMRI I PROJEKTIT
01	Komuna e Gjilanit dhe Komuna e Çairit (projekt i përbashkët i zhvillimit ekonomik) – artizanatet
02	Organizata “REA” – Komuna e Gjilanit dhe Universiteti i Gjilanit si partner (koaplikant)
03	Shoqata “Fruti & Moea” - Komuna e Gjilanit si partner (partner)

EURED - EU REGIONAL ECONOMIC DEVELOPMENT

NR.	EMRI I PROJEKTIT
01	Komuna e Gjilanit dhe Organizata “CARE” (zhvillimi ekonomik lokal dhe i bujqësisë)
02	Komuna e Gjilanit dhe Organizata “MDA” (zhvillimi inkubatorit të bizneseve)
03	Komuna e Gjilanit & Novobërdës dhe Organizata “IADK” (pike për grumbullimin e mjaltit)

PROGRAMI EU – CSP II – IOM

NR.	EMRI I PROJEKTIT
01	Kabienti i informatikës në fshatin Shillovë (IT – kabient)

MINISTRIA E ADMINSTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL - 2014

Programin Komunal për Zhvillim të Infrastrukturës Ekonomike dhe Sociale

NR.	EMRI I PROJEKTIT
01	Ndërtimi i trotuarit rruga “Mulla Idrizi” lagjja Zabeli i Sahit Agës
02	Ndërtimi i sallës se sporteve në shkollën fillore “Rexhep Elmazi” Gjilan

Fondi i MAPL-së për Zhvillimin Ekonomik Regjional (Programi EURED - European Union Regional Economic Development)

NR.	EMRI I PROJEKTIT
01	MODEL I RI DHE VIZION I PËRBASHKËT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK
02	ZHVILLIMI EKONOMIK RAJONAL NEVOJË, JO KERKESË”

Zyra e Projekteve në bashkëpunim me Zyren e Kryetarit dhe Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik ka identifikaur projektet komunale që do të paraqiten (prezentohen) në Konferencën e Donatoreve e cila pritët të mbahet në majin prill (15 – 20 prill).

Nje bashkepunitim te mire gjatë kësaj kohe kemi pasur edhe me zyren e RDA-s në Gjilan .

Ne vazhdim po ju ofrojmë listen e projekteve për te cilat projekte jane plotësuar formularët e veqant ne perputhje me kriteret e prezantimit te percaktura nga Ministria e Integritimeve Evropiane dhe RDA-se, kemi punuar edhe ne identifikimin e projekteve rajonale qe do te prezentohen ne kete konference (20 projekte rajonale)

Megjithatë i mbetet zyres se kryetareve te komunave te regjionit lindje te saktesojne cilat projekte do te prezentohen .

KONFERENCA E DONATOREVE – PROJEKTET KOMUNALE - 2014

Programi Komunal Zhvillimor 2014

NR.	EMRI I PROJEKTIT	VLERA E PROJEKTIT €
01	Ndërtimi i objektit për Administratën Komunale - Gjilan	2,564.452
02	Rregullimi i rrjetit të kanalizmit dhe shtratit të lumit Stanishorka	3,625.872
03	Rruga Magjistrale Gjilan – Prishtinë / sektori Gjilan – penda e Livoqit	3,356.459
04	Ndërtimi i sistemit të ujitjes përgjatë lumit Morava e Binçës	2,030.000
05	Ndërtimi i parkut industrial në vendin e quajtur Gllama – Livoq i Epërm	2,170.020
Σ =		13,746.803

Po ashtu gjate ketyre muajve kemi percjelle projektet dhe kemi bashkepunuar ngusht me Komunitetin Nderkombetar dhe Qeverinë e Kosoves dhe në vazhdim ju ofrojmë skemen e projekteve dhe aktiviteteteve të cilat deri në fund të vitit 2013 kanë qenë në proces e te calat gjatë këtyre muajve zyra e projekteve i ka percjelle per se afermi-proceset e bartura ne vitin – 2014, prej te cilave projekte nga kjo liste disa jane ne fazen e realizmit, disa jane fazen e tederimit dhe disa jane ne fazen e pergatitjes per tender .

PROJEKTET E APROVUARA PËR FINANCIM NGA DONATORËT DHE QEVERIA E KOSOVËS 2013/2014

Programi Zhvillimor 2013/2014

NR.	EMRI I PROJEKTIT	VLERA E PROJEKTIT €
01	Ndërtimi i shkollës së Arteve Pamore – Gjiilan	2,800,000
02	Ndërtimi i objektit të Qendres Rinore	500,000
03	Asfalrimi i rrugëve në Qytet dhe Fshatra	2,400,000
04	Rregullimi i rrjetit të ujësjesit në fshatin Bresalcë	500,000
05	Ndërtimi i objektit të shkollës fillore „Bajram Curri” Shurdhan	500,000
06	Ndërtimi i Qendrës Sportive (tereneve sportive) mbi palestrën e sportive	600,000
07	Ndërtimi i rezervuarit të ujit – 3,000 m3 (Kodra e Dëshmoreve)	1,700,000
08	Ndërtimi i ures në fshatin Pogragjë te Kalaja	120,000
09	Ndërtimi i shtalles për mbajtjen e lopëve, pikën e përpunimit të mishit dhe qumështit dhe piken e grumbullimit të pemeve dhe perimeve	104,305
10	Ndërtimi i objektit të ri të shkollës fillore “Afërdita” në fshatin Kishnapole	346,202
11	Ndërtimi i objektit te Bibliotekes Rajonale	2,000,000
12	Ndërtimi i terenit sportiv ne shkollen fillore “A.Ramadni” ne fshatin Lladove	45,231
13	Projekte te EE (shkolla fillore Ramiz Cernica, Konvikti dhe Gjumnazi)	700,000
14	Lumi Mirusha	3,133,170
15	Kompleksi Memorial “Kodra e Dëshmoreve”-Faza e parë	325,503
16	Kabineti i informatikes (IT kabinet) ne fshatin Shillovë	24,000
Σ =		15,798,411

- Në këtë tabel nuk janë përfshirë projektet e kryera me PPP (ku objekti i ish kadastrit eshte bere pranimi teknik, ndersa objekti afer Drejtorise se Urbanizmit ne proces te pranimit teknik), po ne kete liste nuk jane te perfshira: projekti i Ndërtimit të Objektit të Policisë për të cilën komuna ka participuar dhe eshte ne fazen e realizmit qe ka nje vlere prej (600,000 €) ku Asambleja komunale ka ndare token, te gjitha keto projekte pritet të përfundojnë gjatë të këtij viti .

Sqarim :

Kjo liste e projekteve dhe angazhimeve eshte dashur te perfshihet ne raportin financiar e cila eshte paraqitur ne Komitetin per Politike dhe Financa dhe ne seancën e muajit mars 2014 të Asamblesë Komunale.

Me keto projekte kanë qenë te njoftuar pergjegjësit e financave nga se vetem keshtu kishte me u vlerësue drejt dhe korrekt Raporti Vjetor Financiar – **por megjithate i mbetet ndergjegjjes se tyre per injorim te ketyre shenimeve te sakta.**

Rezyme :

Zyra e Projekteve per keta muaj ka ngritë nivelin e bashkëpunimit me Komunitetin nderkombëtar dhe Institucionet tjera financiare, këtë e kemi bërë me angazhimin më të madh të mundshëm.

Organizatat Nderkombetare me te cilat jemi duke punuar dhe bashkepunuuar :

Zyra Komisionit Evropian, Danish International Development Agency (DANIDA), Qeveria Zvicerane dhe CDI, State Secretariat for Economic Affairs of the Swiss Government – SECO, Cultural Heritage Without Borders (CHwB) - Trashëgimia Kulturore pa Kufi, IPA 2013, Zyra e BE-së në Kosovë (programi Kosova e Bukur) Organizata Ndërkombëtare UNDP - Innovation Centre Kosovo programi Mediat Sociale për Fuqizimin Inovativ Lokal, European Bank for Reconstruction and Development (BERZH) WBIF dhe KFW (Bankën Gjermane për Zhvillim - German Development Cooperation), Programi për të Drejtat Civile-Kosovë (CRP/K), Ambasaden Çeke (CzechInvent dhe UBT) Projekti DEED (Diaspora Engagement in Economic Development) Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) misioni në Kosovë, pastaj programin KOSVET VI, Caritasi i Luxemburgut – programin “ Zbutja e varfërisë përmes Zhvillimit të Qëndrueshëm” UNHABITAT – strategjia e banimit, Riinvest (Development Academy) CBC - Bashkëpunimi Ndërkufitar, EU Regional Economic Development, Programi II (EU- CSP II), programi EURED, GIZ.

Zyra e Projekteve ka ndërtuar ura bashkëpunimi me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe te gjitha Ministrinë. Qeveria e Kosovës është mbështetëse e shumë projekteve për komunën e Gjilanit dhe ne kemi qenë gjithmonë të hapur dhe në dispozicion të të gjithë dikasterëve qeveritarë.

Qeveria e Kosovës (Minsitrite) me te cilat jemi duke punuar dhe bashkepunuuar:

Minisria e infrastruktures, Ministria e Integritimeve Evropiane, Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal, Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve, Minsitra e Mjedisit dhe Planfikimit Hapesinor, Ministria e Punes dhe Mirëqenjes Sociale, Ministria e Diaspores,

Zyra e Projekteve ka një afërsi dhe një kordinim të mirë edhe me shoqërinë civile dhe OJQ e regjistruara në Gjilan, Me të gjitha OJQ-të kemi raporte bashkëpunimi dhe marrim pjesë në të gjitha aktivitetet e tyre që janë në interes të jetës shoqërore, politike, ekonomike, sociale kulturore të Gjilanit, per keta muaj sikur edhe vitet qe lam pas vite Zyra e Projekteve rëndësi të madhe i kushton edhe bashkëpunimit me mediat lokale me të cilat kemi një raport shumë profesional.

E-mail : fadilosmani02@yahoo.com

24 mars ' 2014